



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 491 Prot.

Tiranë, më 05/04 / 2018

Lënda: Dërgohet rekomandim lidhur me trajtimin e rasteve me fleksibilitet kur prindërit/kujdesatrë ligjorë kërkojnë të marrin fëmijet përkohësisht nga Institucionet Rezidenciale.

Drejtuar: SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

TIRANË

SHTËPIA E FËMIJËS 3-6 VJEÇ

SHKODËR

SHTËPIA E FËMIJËS 0-3 VJEÇ

SHKODËR

SHTËPIA E FËMIJËS 6-18 VJEÇ

SHKODËR

SHTËPIA E FËMIJËS 0-6 VJEÇ

TIRANË

SHTËPIA E FËMIJËS 6-18 VJEÇ

TIRANË

SHTËPIA E FËMIJËS 0-6 VJEÇ

KORÇË

SHTËPIA E FËMIJËS 0-6 VJEÇ

VLORË

SHTËPIA E FËMIJËS 6-18 VJEÇ

SARANDE

SHTËPIA E FËMIJËS 0-6 VJEÇ

DURRËS

Të nderuar Drejtorë,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), është një institucion i krijuar me Ligjin Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo lloj sjellje që e nxit atë. Në bazë të ligjit, KMD, ka të drejtë të shqyrtojë ankesa për diskriminim të paraqitur nga individët ose shoqata që pretendojnë se janë diskriminuar, apo të kryejë hetime administrative kur merr informacione për shkelje të ligjit. Komisioneri kur e shef të arsyeshme, drejton rekomandime autoriteteve kompetente për çështje që lidhen me diskriminimin.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i kanë mbërritur disa ankesa nga prindër të cilët, të detyruar nga situata e vështirë ekonomike, i kanë lënë fëmijët për të marrë shërbime përkujdesi në institucionet rezidenciale për fëmijë dhe nuk lejohen që ti marrin fëmijët as përkohësisht (për ditëlindje, raste festash), në shtëpitë e tyre.

Në rastet e shqyrtuara nga Komisioneri, nga ana e përfaqësuesve të Shtëpive të Fëmijës është pretenduar se kanë zbatuar shkresën nr. 1963 Prot., datë 18.09.2015 të dërguar nga Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror për Institucionet Rezidenciale për fëmijë ku ndër të tjera thuhet: ***“Kur fëmijët janë në kujdestari ligjore të prindërve, por marrin shërbim në qendër përkujdesi, ata mund të largohen nga institucioni në mënyrë të përkohëshme por edhe të përhershme, vetëm në rastet kur vlerësimi social ekonomik, i kryer nga NJMF/administrator shoqëror parashtron përmirësimin e kushteve të familjes biologjike...”***. Shkresa e Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror, mbështetet në VKM nr. 659 datë 17.10.2005 *“Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët e Institucioneve Rezidenciale”* dhe VKM nr.658 datë 17.10.2005 *“Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”*.

Nga shqyrtimi që ju bë akteve nënligjore, nr. 659 datë 17.10.2005 *“Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët e Institucioneve Rezidenciale”* dhe VKM nr.658 datë 17.10.2005 *“Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”*, dolëm në konkluzionin se:

Këto akte nënligjore përcaktojnë standarte ose parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e shërbimeve shoqërore dhe cilësinë e përkujdesit shoqëror për fëmijët. Aktet nënligjore në fjalë, e veçanërisht VKM nr. 659 datë 17.10.2005 *“Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët e Institucioneve Rezidenciale”*, nuk përmban parashikime lidhur me mundësinë e largimit të fëmijës, qoftë edhe përkohësisht, nga institucionet rezidenciale pa u përmirësuar kushtet social-ekonomike të familjes biologjike.

Akti nënligjor i cili përmban parashikime të situatës ekonomike nga prindi është VKM nr. 425, datë 27.06.2012 *“Për përcaktimin e kriterëve, dokumenteve të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publikje, të përkujdesjes shoqërore”*. Kjo VKM përcakton se pranimi i fëmijës në qendrat rezidenciale bëhet me kërkesë të prindit, i cili ndodhet në pamundësinë ekonomike (*Kjo shoqërohet me dokumente provuese*). Kërkesa e prindit shqyrtohet nga një komision multidisiplinor i cili më pas vendos nëse fëmija do të pranohet ose jo në institucionet rezidenciale. Kjo VKM nuk ka ndalime ose parashikime për rastet kur prindërit duan të marrin fëmijët e tyre.

Si rrjedhojë, shkresa e Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror¹, e cila ka udhëzuar institucionet vartëse të saj, për mos largimin e fëmijëve (me kërkesë të prindit) nga institucioni në mënyrë të përkohëshme por edhe të përhershme, në rastet kur vlerësimi social ekonomik, i kryer nga NJMF/administrator shoqëror parashtrohet mos-përmirësimin e kushteve të familjes biologjike, në vlerësimin tonë, nuk ka mbështetje ligjore në VKM-të e sipërcituara.

Duke pasur parasysh, këto parashikime ligjore, Komisioneri vlerëson se institucionet rezidenciale për fëmijë duhet të kenë një praktikë më të zbutur dhe duhet treguar me tepër fleksibilitet, në rastet kur prindërit, kërkojnë marrjen përkohësisht të fëmijëve të tyre, që kanë në kujdestari ligjore, por që marrin shërbim në qendër përkujdesi.

Komisioneri vlerëson, se nuk mund të ndalohen prindërit të marrin përkohësisht fëmijët e tyre, që jetojnë në qendër rezidenciale edhe nëse nuk provojnë dot përmirësim të gjendjes sociale-ekonomike. Në raste të tilla, vendimarrja duhet bërë rast pas rasti duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Përsa u shprehëm më sipër, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON:

- **Marrjen e masave për rritjen e fleksibilitetit në trajtimin e rasteve, kur prindërit kërkojnë të marrin përkohësisht fëmijët e tyre, nga Institucionet Rezidenciale edhe në rastet kur vlerësimi social-ekonomik nga Njësia e Mbrotjes së Fëmijës/administratori shoqëror nuk parashtrohet përmirësim të kushteve.**

IRMA BARAKU



¹ Mbështetur në VKM nr. 659 datë 17.10.2005 "Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët e Institucioneve Rezidenciale" dhe VKM nr.658 datë 17.10.2005 "Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore".